



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | |
|---|------------|-----------------------------------|
| Pranuar / Dostigjen / Primljeno / Pristalo / Received / Dostigjen / | 08.08.2022 | viti / god / year |
| Organ / Objekti / Org. / Unit / | 4591/2022 | Sasia / Kolicina / Quantity |
| | | 1/4 |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.637/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.637/2022 të datës 21.07.2022 të parashtruar nga ankuesja nga Prishtina, me adresë banimi

kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës-mos aprovim i pushimit pa pagesë*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 08.08.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet* si e bazuar ankesa me numër A.nr.637/2022 e datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesja
- II. *Obligohet* Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore lidhur me aprovimin e kërkesës së ankueses të datës 13.07.2022 për pushim pa pagesë si dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim më dispozitat ligjore të aplikueshme.
- III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë me datë 21.07.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 4218/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, kundër shkresës me numër protokollit 05-3473 të datës 14.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave ligjore si dhe zbatimit të gabuar të dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 25.07.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli, me datë 04.08.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës pasi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet për pranueshmerinë e ankesës siç përcaktohet me nenin 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 4218/2022 të datës 21.07.2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; -përgjigje me numër protokollit 05-3473 të datës 14.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë; Kërkesën e datës 13.07.2022 nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt dhe Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimin nr.1125/2016 i datës 08.02.2017, Kontratën mbi financimin e shkollimit Specialistit e datës 02.05.2016 me numër të specializantit 1125/2016; Akt emërimi i datës 31.10.2013; Përshkrimin e punës i datës 31.10.2013; Raportin mjekësor i datës 02.08.2022; E-mail i datës 04.08.2022-raport mjekësor; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4528/2022 e datës 04.08.2022; E-mail i datës 04.08.2022; Vendimin me numër protokollit 05-2622 të datës 24.04.2018 mbi transferimin e përkohshëm të nëpunëses civile/ankueses; kërkesën për vazhdimin e transferit të ankueses me numër protokollit 05-2610 të datës 24.04.2018; Vendimin me numër protokollit 05-3346 të datës 04.05.2017 mbi transferimin e nëpunëses civile/ankueses.

Kolegji për Shqyrtimin e dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses dhe pas analizimit të provave të lëndës ka konstatuar se ankesa e ankueses
është e bazuar, sepse:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës gjegjësisht sipas Akt Emërimit të datës 31.10.2013, Kolegji ka konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës "Inspektor Farmaceutik", në Inspektoratin Farmaceutik/IFPPM-së në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë. E njëjta me datë 13.07.2022 përmes mbikëqyrësit të saj gjegjësisht Udhëheqësit të Divizionit për Farmaci ka parashtruar kërkesë të Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, për aprovim të pushimit pa pagesë në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, për arsye të vazhimit të specializimit të ndarë nga Ministria e Shëndetësisë për profesionistë shëndetësor-specializimin për Toksikologji, sipas Vendimit me numër 1125/2016 të datës 08.02.2017.

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë përmes shkresës me numër protokollit 05-3473 të datës 14.07.2022 ka refuzuar kërkesën e ankueses të datës 13.07.2022 si të pabazuar, me arsyetimin se kërkesa nuk përmbush kriteret e parapara ligjore për pushimet e zyrtareve publikë dhe kërkesa përkon me periudhën kur vendi ballafaqohet me nismën e një vale të re të pandemisë e cila mund të ndikoj në kufizimin e resurseve në Divizionin e Farmacisë.

Ankuesja e pakënaqur me mos aprovimin e kërkesës për pushim pa pagesë, brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendime ankimore së përgjigja është nxjerrë në kundërshtim me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe nenin 14 paragrafin 1 dhe paragrafin 2 nën paragrafin 2.1 të Rregullores Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë si dhe arsyetimi i aktit nuk është dhënë konform ligjit në fuqi. Me tej shton se kërkesa bazohet në ngritjen profesionale të ankueses gjegjësisht e njëjta për shkak të situatës së pandemisë nuk kishte arritur që të përfundonte specializimin, kështu që propozon që Këshilli ta aprovoj anekses si të bazuar dhe të aprovoj pushim imin pa pagës në kohëzgjatje prej 6 muajsh duke filluar nga data 01.08.2022 deri me 31.01.2023.

Në kuptim të vendosjes meritore të kësaj çështje juridike-administrative, Kolegji sjell në vëmendje faktin se bazuar në Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht sipas nenit 18 paragrafi 4 të këtij ligji, pushimet e zyrtareve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës, ndërlidhur me



ketë e drejta e pushimit të nëpunësve civil është përcaktuar edhe me Rregulloren (QRK) Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë.

Kolegji i Këshillit lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankueses, ka analizuar dispozitat e nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës me të cilin është theksuar se: "1. Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. 2. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1. i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit", ndërsa Rregullorja Nr.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, përkatësisht neni 14 ka përcaktuar se: 1. Zyrtari publik gëzon të drejtën për pushim pa pagesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës. 2. Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të:.... 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional... 3. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni zyrtari publik duhet të paraqet kërkesë të arsyetuar për pushim pa pagesë. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Vendimi i dorëzohet pa vonesë Zyrtarit dhe Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore. 4. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1 i këtij neni, të zyrtarit publik i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave për rikthim në vendin tij të punës, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së nëpunësi-ja civil/e ka të drejtë që të kërkoj pushim pa pagesë për arsye të ngritjes profesionale dhe i/e njëjti/a me përfundimin e pushimit pa pagesë, ruan të drejtën e kthimit në vendin e tij të punës të mëparshëm apo në një pozitë të ngjashme ekuivalente, andaj, nisur nga kjo gjendje juridike dhe duke marr parasysh së kërkesa e ankueses bazohet në arsyet dhe qëllimin e ngritjes profesionale, Kolegji vlerëson se është i bazuar pretendimi i ankueses që të aprovohet pushimi pa pagesë lidhur me aftësimin profesional respektivisht për vazhdimin e specializimit sipas kërkesës së ankueses të datës 13.07.2022.

Në pajtueshmëri me dispozitat ligjore si me lartë, ankuesja bartë detyrimin e njoftimit të organit të punësimit lidhur me ndërprerjen, ndryshimin si dhe përfundimin e programit për aftësim profesional si dhe detyrimin e shfrytëzimit të së drejtës për pushim pa pagesë në pajtim dhe brenda periudhës kohore të lejuar me vendimin e organin të punësimit siç përcaktohet në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Nisur nga rrethanat dhe të gjeturat si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton së Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë, me rastin e refuzimit të kërkesës së ankueses të datës 13.07.2022 për lejim të pushimit pa pagesë për arsye të ngritjes profesionale-specializimit, nuk ka vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe plotë gjendjen faktike dhe në këtë mënyrë nuk ka zbatuar drejtë ligjin material, kështu që mbi këtë bazë obligohet i njëjti që të ndërmerr të gjitha veprimet ligjor lidhur me aprovimin e kërkesës së ankueses të datës 13.07.2022 për pushim pa pagesë si dhe të nxjerrë akt administrativ në pajtim me dispozitat ligjore të aplikueshme.

Theksuar si me lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-

Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.637/2022

Ilire Mehmeti SHAQIRI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Shëndetësisë ;
- Udhëheqëses së Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

